



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:229804

Datë: 17.01.2024

Numri i dokumentit: 05202674

P.2023:189023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Dega në Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal, Gjyqtari Burim Çaka, dhe bashkëpunëtori profesional Ismail Kuçi, në çështjen penale kundër të pandehurit K.I, i shpallur fajtor për veprën penale Vjedhje Pylli nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr. 898/2023 të datës 04.09.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik, më datë 30.01.2024, në praninë e Prokurores së Shtetit Mimoza Sylja - Hyseni, të pandehurit, përfaqësuesit të palës së dëmtuar Komuna e Hanit të Elezit – Enver Thaqi, më datë 02.02.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 22.02.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: K.I nga në fshati ... Komuna e Kaçanikut, i lindur më datë ..., nga i ati J... dhe e ëma M... e gjinisë T..., me numër personal ..., i martuar, prind i pesë fëmijëve, ka të kryer shkollën mesme, pensioner-veteran i UÇK-së, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës e Kosovës

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 13.06.2023 rreth orës 13:50, në vendin e quajtur “Rrafshi i lopëve”, Rajoni Ekonomiko-PyJOR Bodoshnjak, Hani i Elezit të cilin e menaxhon Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti PyJOR Komunal Hani i Elezit, me qëllim vjedhje me sharrë motorike kishte prerë 26 copë drunjë të llojit bung , të gjata 11m, me diametër 16 cm, me vëllim 2.60 m³, të cilën masë drunore e kishte bartur me kuaj samari, ku vlera e dëmit të shkaktuar është 332,80 €.

-Me të cilat veprime ka kryer veprën penale Vjedhje Pylli nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së

Duke u bazuar në nenet 2, 17, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së dhe nenit 358, 360, 364 dhe 452 të KPPK-së të pandehurin e:

G J Y K O N

I. Me dënim me gjobë në shumë 600€ (Gjashtëqind euro), të cilin dënim me gjobë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në 2 këste të barabarta në afat prej 2 muajve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi me gjobë do t’i zëvendësohet, me dënim me burgim duke llogaritur nga 1 ditë burgim për çdo 20 € (njëzet euro) të pa paguara, nëse kësti nuk paguhet me kohë, mundësia e pagesës me këste revokohet.

II. Obligohet i pandehuri që palës së dëmtuar t’ia paguaj dëmin në vlerë 332.80€, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

III. Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale dhe paushallit gjyqësor, t’i paguaj kësaj gjykate shumën prej 50.00€ dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 20.00€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr. 898/2023 të datës 04.09.2023, kundër të pandehurit të lartshënuar, për shkak të veprës penale Vjedhje pylli nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së, i ka propozuar gjykatës, që të pandehurin ta shpall fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni penal konform ligjit në fuqi.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj aktakuze, si dhe konform nenit 240 të KPPK-së, caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor më datë 30.01.2024

Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit, i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se është penduar dhe i ka kërkuar falje palës së dëmtuar.

Prokurori i Shtetit ka shprehur pikëpamjet lidhur me pranimin e fajësisë, ka theksuar se nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga i pandehuri për veprën penale për të cilën është akuzuar në bazë të kësaj aktakuze pasi që një pranim të tillë e bëri vullnetarisht i ka propozuar gjykatës që a aprovoj pranimin e fajësisë dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar sa i përket matjes dhe shqyrtimit të dënimit gjykata të ketë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese ku si rrethanë lehtësuese të merret parasysh pranimi i fajësisë në këtë shqyrtim gjyqësor ndërsa si rrethanë rënduese gjykata të ketë parasysh se i pandehuri ka kryer veprën penale ndaj të dëmtuarës duke i shkaktuar dëm pasurore në vlerë 332.80€.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar ka dhënë pikëpamjet lidhur me pranimin e fajësisë dhe ka deklaruar i bashkëngjitemi ndjekjes penale dhe parashtrojmë kërkesë pasurore juridike.

Vlerësimi i pranimet të fajësisë

Pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë gjatë fillimit të shqyrtimit gjyqësor, gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe pikëpamjet e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 242 par 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se: i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimet të fajit; Pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokuroria e Shtetit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore; Akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke vlerësuar në aspektin e figurës së veprës penale gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit plotësohen të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Vjedhje pylli nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së, në mënyrë kohë dhe vend si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Rrethanat për matjen e dënimit

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurit, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69, 70 të KPRK-së, si rrethanë lehtësuese gjeti se: i njëjti e ka pranuar fajësinë në fillim të shqyrtimit gjyqësor, deklarimin se është penduar për veprimet që ka bërë, premtimin se nuk do të përsëris vepra penale në të ardhmen, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata gjeti se edhe pse për të pandehurin nuk ka gjetur vendime të formës së prerë të natyrës penale, por duke u bazuar në të dhënat të gjeneruara në sistemin SMIL, ka rezultuar se i njëjti është dëmtues i rregullt i pyllit, ku ka një numër të konsiderueshëm të vendimeve kundërvajtëse të formës së prerë të kësaj natyre.

Gjykata, të pandehurit i shqiptoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e marrë për bazë minimumin dhe maksimumin dhe qëllimin e dënimit dhe duke u bazuar në rrethanat lehtësuese dhe është i bindur se edhe me një dënim të tillë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i

justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPPRK-ës, gjykata ka vendosur që të pandehurit ti obligoj që t'ia paguaj palë së dëmtuar dëmin në vlerë 332.80€, duke u bazuar në Fletëparaqitja e rojtarit të natyrës me nr.90/2021, 30.06.2023 në të cilën është bërë llogaritja në kubaturë e drunjëve të prera si dhe vlera e dëmit, ku si pjesë e sajë është edhe procesverbali i komisionit të ekspertëve të pylltarisë për vlerësimin dhe konstatimin e dëmit, e llogaritur sipas çmimoreve së përcaktuar në rregulloren e MMPH Nr.1-15 për shërbimet e Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe institucioneve të sajë.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata vendimin mbi shpenzime e procedurës dhe paushallit gjyqësor e mori konform neneve 450 dhe 452 të KPPK-ës.

Gjykata vendimin mbi Kompensimin e Viktimave të Krimit e mori konform nenit 36 paragrafi 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPPK-së, u vendos si n dispozitivin e këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Dega në Kaçanik

P.2023:189023, më datë 22.02.2024

Procesmbajtësi:

Ismail Kuçi

Gjyqtari:

Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi.
Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme.

Numri i lëndës: 2023:170850
Datë: 22.02.2024
Numri i dokumentit: 05356458